



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCË, BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 3833 Prot.

Fier me. 25.03.2026

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 35, datë 25.03.2026

**“Për miratimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Qirjako Ferti në vlerën prej 84,000 lekësh”**

Të nderuar këshilltarë,

Projekt-Vendimi “Për miratimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Qirjako Ferti në vlerën prej 84,000 lekësh” është përgatitur në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Per Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);
- Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier Nr. 118 , dt 11.12..2025 «Për miratimin e Programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2026-2028 përfundimtar dhe miratimin e buxhet të vitit 2026 », Miratimin nga Prefektura Fier me nr.1370/1 dt 24.12.2025
- Kërkesës nr.21 prot.,datë 13.03.2026 protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.3523 prot.,datë 17.03.2026 të Administratorit të Njësisë Administrative Nr.3 Fier, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Qirjako Ferti më datë 05.03.2026, dhe dokumentacionit të dorëzuar nga Ndërmarrja e Menaxhimit të Parqeve dhe Gjellbërimit, protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.3674 datë 19.03.2026 “Dërgim i dokumentacionit të shërbimit të varrimit të organizuar nga Ndërmarrja e Menaxhimit të Parqeve dhe Gjellbërimit ”,

**PROPOZJMË:**

1. Miratimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Qirjako Ferti në vlerën prej 84,000 (*tetëdhjetë e katër mijë*) lekës, i cili ishte i braktisur nga familjarët , sipas dokumentacionit përkatës financiar të dorëzuar nga Ndërmarrja e Menaxhimit të Parqeve dhe Gjellbërimit.
2. Ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për zbatimin e këtij vendimi.

**Drejtoria e Financë, Buxhetit dhe Kontabilitetit**  
**Pranvera Çina**

**Drejtoria Juridike**  
**Esmeralda Kapllanaj**

**KRYETARI**  
**Armando Subashi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**Zv.Kryetar**  
**Mariglen Hoxha**

